<p>raste nevojë të sigurojë largimin e lehtë të bombolave.</p> <p>24.3 Të paktën njëri nga muret e mjedisit të magazinimit të jetë njëkohësisht mur i jashtëm i ndërtesës.</p> <p>24.4 Materialet e ndërtimit të mjedisit të magazinimit duke përfshirë veshjet e mureve dhe ato që ndajnë magazinën nga pjesa tjetër e ndërtesës, duhet të jenë rezistente ndaj zjarrit së paku për dy orë.</p> <p>24.5 Mjedisi i magazinës duhet të ketë hapje të përhershme me ambientin e jashtëm për ajrosje. Hapjet duhet të jenë të shpërndara mirë, në dy mure përballë njëri tjetrit dhe me sipërfaqe të përgjithshme të hapjeve jo më pak se 1 % të sipërfaqes së mureve anësore dhe të tavanit.</p> <p>24.6 Dyshemeja në mjedisin e magazinimit duhet të jetë e përbërë prej materialit të padjegshëm, të jetë horizontale, kompakte, pa kanale dhe gropëzime dhe në nivel të njëjtë ose pak më lartë (por jo më shumë se 1.2 metra) nga niveli i tokës përreth. Dyshemeja duhet të mbahet gjithmonë e pastër dhe të mos ketë objekte të huaja e sidomos materiale të ndezshme.</p>	<p>kretanje na takav način da u slučaju potrebe da osigura brzo i lako odstranjivanje boca.</p> <p>24.3 Najmanje jedan zid prostora za magaziniranje da bude istovremeno i vanjski zid zgrade.</p> <p>24.4 Građevinski materijali prostorije magaziniranja, obuhvataći i malterisanje zidova i one koje razdvajaju magazin od ostalih delova zgrade, treba da bude otporna prema vatri najmanje za dva sata.</p> <p>24.5 Prostorija magazina treba posedovati stalne otvore sa spoljnim ambijentom za provetranje. Otvori treba biti dobro raspoređeni, na dva suprotna zida i sa površinama ne manje 1 % površine bočnih zidova i tavana.</p> <p>24.6 Pod u prostoriji magaciniranja treba biti od vatrostalnog materijala, da bude horizontalan, kompaktn, bez rupa i neravnina i istom nivou ili malo viši (ali ne više od 1.2 metara) od nivoa zemlje unaokolo. Pod treba se stalno održavati čist i da ne postoje strani objekti i naročito zapaljive materijali.</p>	<p>24.3 At least one of the storage area walls should be in the mean time an outer wall of the building.</p> <p>24.4 The construction materials of the storage environment including the coating and other decoration should be fireproof for at least 2 hours.</p> <p>24.5 The storage area should have permanent openings with out-doors for ventilation. The openings should be well put out, in two walls in front of each other and of general surface of the openings not less than 1% of the sidewalls and ceiling.</p> <p>24.6 The floor should consist of fireproof material, should be horizontal, compact, and in the same or higher quote (not more than 1.2 meters) as the surrounding terrain. The floor should always be kept clear of foreign objects or flammable materials.</p>
--	--	---

<p>24.7 Mjedisi i magazinës duhet të ketë dy dalje, por jo pranë njëra tjetrës nga të cilat mund të dilet në ambientin e jashtëm. Dyert të hapen nga jashtë dhe rrugët e daljes të jenë pa pengesa.</p> <p>24.8 Pozicioni në ndërtesë i mjedisit të posaçëm për magazinimin e bombolave të GLN-së, duhet të jetë e tillë që distanca më e vogël midis saj dhe hapjeve të mureve dhe çdo objekti tjetër që nuk i përket magazinës, të përputhet me të dhënat e Tabelës 6. Në rast magazinimi të përzier (bombola të rimbushëse dhe bombola për një përdorim) sasitë e përgjithshme të magazinimit të Tabelës 6 përgjysmohen. Kur objektet fqinjë të ndërtesës janë magazina të lëndëve që digjen shpejt, largësia prej 3 m bëhet 4 m dhe largësia 4 m bëhet 6 m.</p> <p>24.9 Kur magazinohen bombola për një përdorim të GLN-së, sasitë e Tabelës 5 duhet të jenë në pajtim edhe me kufizimet sipas pikës 22.8.</p> <p>24.10 Në vendin e magazinimit nuk duhet të ketë materiale të ndezshme me përjashtim të atyre që përmenden në pikën 22.8 a).</p>	<p>24.7 Prostor magazina treba posedovati dva izlaza, ali ne jedan pored drugog, iz kojih se može izlaziti u spoljnom ambijentu. Vrata da se otvaraju spolja i putevi izlaza da budu bez prepreka.</p> <p>24.8 Pozicija u zgradu i posebnog prostora za magaziniranje boca TGN-a, treba da bude takav, da njegova najmanja razdaljina između njih i otvora u zidovima i svakog drugog objekta koji pripada magazinu, da bude u skladu sa podacima iz Tabela 6. U slučaju mešovitoz magaziniranja (boca koje se pune i boca za jednu upotrebu) ukupne količine magaziniranja iz Tabele 6. se prepolovljuju. Kada se susedni objekti zgrade su magazini materijala koji lako izgaraju, razdaljina od 3 m postaje 4 m i daljina 4 m postaje 6 m.</p> <p>24.9 Kada se magaziniraju boce za jednu upotrebu TGN-a, količine iz Tabele 5 trebaju biti u skladu sa ograničenjima prema tački 22.8.</p> <p>24.10 U mestu magaziniranja ne sme postojati izgorljivi materijali izuzev onih koji su napomenuti u tački 22.8 a).</p>	<p>24.7 The storage environment should have two exits, but not next to each other. The doors should open from the outside and the exit ways should be kept clear.</p> <p>24.8 The location of the storage area for LPG containers should be in a manner that the shorter distance and the walls and other objects, should be in accordance with data on chart 6 regarding the distances of the openings of itself and any other building. In case of a mixed storage (replenish containers and containers for one use), the general quantities are dimidiated. When neighbor facilities are flammable material storing facilities, the distance of 3 meters becomes 4, and when it's 4, it becomes 6.</p> <p>24.9 When LPG containers are stored, the quantities in chart 5 should be in accordance with the restrictions in 22.8.</p> <p>24.10 When LPGs are stored, in the storage area are no flammable materials allowed except the ones mentioned in 22.8 a).</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 25 Kushtet e përgjithshme të magazinimit të gazit të lëngëzuar në bombola</p>	<p style="text-align: center;">Član 25 Opšti uslovi magaziniranja tečnog gasa u bocama</p>	<p style="text-align: center;">Article 25 The general conditions of the LPG container storage</p>
<p>25.1 Čdo bombol që nuk është mbushur asnjëherë me GLN ose që i është nënshtruar procedurës përkatëse të heqjes së GLN-së dhe ka shënimet përkatëse, sa i përket përdorimit nuk konsiderohet si bombol për GLN në aspektin e sigurisë.</p> <p>25.2 Të gjitha enët e tjera të GLN-së duhet të konsiderohen si enëplote sado qoftë përmbajtja e GLN-së në to. Bëjnë përjashtim bombolat e reja të papërdorura ndonjëherë për të cilat zbatohen dispozitat e nenit 26.</p> <p>25.3 Čdo vend magazinimi dhe veçanërisht stivimi i bombolave të GLN-së duhet të jetë i thjesht për t'u njohur për të lehtësuar largimin e shpejt në rast rreziku. Po të jetë e mundur, perimetri i zonës së rrezikshme të shënohet në tokë.</p> <p>25.4 Në çdo hyrje të zonës së magazinimit vendosen në mënyrë të dukshme tabela të përherëshme me shkronja të kuqe me madhësi 50 mm, me mbrapavi të bardhë me mbishkrimin “Gazi i lëngëzuar shumë i</p>	<p>25.1 Svaka boca koja nije nijednom punjena sa TGN-om, ili koja je podvrgnuta odjedenoj proceduri za odstranjivanje TGN-a i kada postoje odredjeni podaci, što se tiče korišćenja ne smatraju se boce za TGN iz sigurnosnog vida.</p> <p>25.2 Sve ostale posude TGN-a trebaju se smatrati kao pune posude, i bilo kojoj količini TGN-a u njima. Izuzetak čine nove boce koje nisu korišćene neki put za koje se primenjuju dispozicije iz Člana 26.</p> <p>25.3 Svako mesto magaziniranja i naročito slaganje boca TGN-a, treba biti prosto za upoznavanje i za brzo odstranjivanje u slučaju opasnosti. Ako je moguće, poluprečnik opasne zone, treba se zabeležiti u zemlji.</p> <p>25.4 U svakom ulazu zone magaziniranja, postavljaju se na vidan način stalne tablice sa crvenim slovima i veličine 50 mm, sa belom pozadinom sa natpisom «Tečni gas veoma zapaljiv». Strogo je zabranjeno</p>	<p>25.1 Every container that has ever been filled or it not submitted to corresponding clearance procedure has the corresponding notes regarding the usage, is not considered as a LPG container in the safety aspect.</p> <p>25.2 Every other container should be considered as full regardless of the quantity of LPG in it, except the un-used new containers, which apply to the provisions in article 26.</p> <p>25.3 Every storage area and especially the stocking of the LPG containers should be simple to know and to ease the getaway in cases of emergency. If possible, mark the perimeter of the dangerous area on the ground.</p> <p>25.4 Permanent, red-ink with white background signs should be placed with the in every entrance of the storage area “Liquid Gas. Flammable”. Employees only.</p>

<p>ndezshëm”. Ndalohet rreptësishtë afrimi i të papunësuarve në magazinat e GLN-së.</p> <p>25.5 Bombolat e GLN-së nuk duhet të magazinohen pranë enëve që përmbajnë gaze të tjera ose lëndë të tjera të rrezikshme.</p> <p>25.6 Bombolat mund të stivohen në këmbë ose horizontalisht. Në rastin e stivimit horizontal, bombolat e skajeve duhet të kenë mbështetje të posaçme të qëndrueshme. Ventilet duhet të jenë të mbyllura, madje dhe në bombolat bosh. Bombolat plot duhet të kenë tapa ose mbulesa në ventile.</p> <p>25.7 Bombolat nuk duhet të vendosen në mjedise ku ekziston mundësia që temperatura të ngrihet mbi 50 °C.</p> <p>25.8 Ndalohet prania e çfarëdo burimi ndezjeje në magazinat e mbyllura si dhe ngrohja me pajisje me flakë inkandeshente.</p>	<p>približavanje magazinima TGN-a od strane nezaposlenih.</p> <p>25.5 Boce TGN-a ne trebaju se magazinirati u blizini posuda koja sadrže druge gasove ili ostalih opasnih materijala.</p> <p>25.6 Boce se mogu naslagati stojeći ili horizontalno. U slučaju horizontalnog slaganja, krajnje boce trebaju imati posebne podupirače koji su stabilni. Ventili trebaju biti zatvoreni, čak i u praznim bocama. PUNE boce trebaju posedovati zapašaće ili pokrivače u ventilima.</p> <p>25.7 Boce ne trebaju se postavljati u prostorijama gde postoji mogućnost da temperatura bude viša od 50 °C.</p> <p>25.8 Zabranjuj se prisutnost bilo kakvog izvora paljenja u zatvorenim magazinima kao i opreme za inkandeshentni plamenom.</p>	<p>25.5 The LPG containers should not be stored next to the containers holding other gases or other dangerous materials.</p> <p>25.6 The containers should be stocked horizontally or up wise. In case of a horizontal storage, the endings should have a special permanent support. Facets should be closed, even in empty containers. The containers should have corks or covers on the facets.</p> <p>25.7 The containers should not be placed in areas where the chance exists that the temperature increases above 50 °C.</p> <p>25.8 No presence of any kind of heat source is allowed on the closed storage rooms also the heating with incandescent fire.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 26 Kontrolli i rrjedhjeve</p> <p>26.1 Çdo herë kur pranohen për magazinim bombola të GLN-së, duhet të bëhet kontroll për verifikimin e rrjedhjeve</p>	<p style="text-align: center;">Član 26 Kontrola curenja</p> <p>26.1 Svaki put kada se primaju za magaziniranje boce TGN-a, treba se izvršiti kontrola i verifikacija mogućih</p>	<p style="text-align: center;">Article 26 Control of leaks</p> <p>26.1 Every time when a container is accepted for storage, a leak verification control should be done.</p>

<p>të mundshme të gazit.</p> <p>26.2 Kontrolli i rrjedhjeve të mundshme nuk duhet të bëhet kurrë me mjete me flakë të hapur ose me shkëndija, por gjithmonë në bazë të njërit nga treguesit karakteristike të mëposhtme;</p> <ul style="list-style-type: none"> a) erës karakteristike të GLN-së; b) fërshëllimës së gazit që rrjedh; c) kondensimit ose ngrirjes së avujve të GLN-së rreth pikës ku ndodh rrjedhje; d) kontrolli me fluska të detergjentit. <p>26.3 Në magazinat e mbyllura të GLN-së me kapacitet magazinimi nga 500 deri 1000 kg për bombolat rimbushëse dhe 500 kg deri 2500 kg për bombola për një përdorim, duhet të ketë së paku një zbulues të përzierjes shpërthyes gaz-ajër. Për kapacitete magazinimi mbi 1000 kg për bombolat e rimbushëse dhe 2500 kg për bombolat për një përdorim është i detyrueshëm sistemi automatik i përhershëm për zbulimin e përzierjes shpërthyes. Për magazinim të përzier të</p>	<p>curenja gasa.</p> <p>26.2 Kontrola mogućih curenja, ne treba se izvršiti priborom koji poseduje otvoreni plamen ili iskre, nego uvek na osnovu jednog od dolepoznatih karakterističnih pokazatelja:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) karakterističnog mirisa TGN-a; b) fjučkanje gasa koji curi; c) kondenzacija ili smrzavanje para TGN-a oko tačke gde se događa curenje; d) kontrola sa mehuricima deterdženata. <p>26.3 U zatvorenim magazinima TGN-a sa maksimalnim kapacitetom od 500 do 1000 kg za boce koje se pune i 500 kg do 2500 kg za boce za jednu upotrebu, treba postojati najmanje jedan otkrivač praskavih masnih-vazdušnih smesa. Za kapacitete magaziniranja 1000 kg za boce koje se pune i 2500 kg za boce za jednu upotrebu, obavezan se automatski sistem otkrivanja eksplozivnih mešovina. Za mešovito magaziniranje boca koja se pune i za jednu upotrebu, gorenavedene količine</p>	<p>26.2 The control of the possible leak should never be done with gadgets with open fire or spark, but always regarding the characteristics below:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) the characteristic smell of LPG; b) the whistle of leaking gas; c) the condensation or freezing of the vapors of LPG around the part where it's leaking; d) the bubble check. <p>26.3 In the closed storage rooms of LPG with the capacity of 500 up to 1000 kg for replenish containers and 500 kg up to 2500 kg per container for one use, there should be at least 1 detector of the explosive gas-air mix. For storage capacities over 1000 kg for replenish containers and 2500 kg for one use containers is obligatory permanent automatic system for discovering of explosive mixture. For mixed storage of replenish containers and containers for one use, the mentioned quantities dimidiate.</p>
---	---	---

<p>bombolave rimbushëse dhe për një përdorim, sasi të e mësipërme përgjysmohen.</p> <p>26.4 Në rast se bombola rrjedh dhe rrjedhja nuk ndalohet duke mbyllur ventilin, bombola duhet të largohet nga magazina dhe të dërgohet në vendin e caktuar sa më larg ndërtesave dhe burimeve të shpërthimit dhe me pjesa që rrjedh vendoset lart. Në këtë rast njoftohet furnitori dhe merren masat për ndalimin e rrjedhjeve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 27 Magazinimi i bombolave bosh</p> <p>27.1 Bombolat boshe të GLN-së kur magazinohen bashkë me ato të plota, duhet të konsiderohen bombola të mbushura për sa i përket distancave të sigurisë.</p> <p>27.2 Ndarja e bombolave boshe është e këshillueshme dhe atje ku mund të bëhet, lejohen të përdoren rregulla sigurie më elastike dhe distanca të sigurisë më të vogla, me kusht që të respektohen kërkesat e më poshtme:</p>	<p>se prepolovljuju.</p> <p>26.4 U slučaju kada boca curi i curenje se ne prekine zatvaranjem ventila, boca se treba odstraniti iz magacina i da se pošalje što je moguće dalje od magazina i da se pošalje na određenom mestu što je moguće dalje od zgrada i izvora eksploziranja, i da delom koji cure da se postavi prema gore. U ovom slučaju obaveštava se snabdevač i preduzimaju se mere za odstranjivanje curenja.</p> <p style="text-align: center;">Član 27 Magaziniranje praznih boca</p> <p>27.1 Prazne boce TGN-a kada se magaziniraju zajedno sa punim, trebaju se smatrati punim bocama, što se tiče razdaljina sigurnosti.</p> <p>27.2 Podela praznih boca je preporučljivo i tamo gde se može to uraditi, pod uslovom da se poštuju dolenavedeni zahtevi:</p>	<p>26.4 In case that the container is leaking and the leaking won't stop if we turn the facet, the container should be removed far away of the buildings, and the dealer should be noticed and measurements are to be taken to stop the leaking.</p> <p style="text-align: center;">Article 27 The storage of empty containers</p> <p>27.1 When empty containers are stored together with filled ones, they should be considered filled regarding the safety measurements.</p> <p>27.2 The separation of the containers is advised, and if possible, bending rules in order to fulfill the requirements below:</p>
---	---	--

<p>a) magazina e bombolave bosh të GLN-së duhet të jetë në ambient të hapur;</p> <p>b) bombolat boshe të magazinohen në stiva të veçanta dhe perimetri i zonës së magazinimit të shënohet qartë në tokë dhe në vend të dukshëm të vendoset një tabelë ku shkruhet: “VETËM BOMBOLA BOSH”;</p> <p>c) të kryhet kontrolli i rreptë për të siguruar vetëm magazinimin e bombolave bosh në zonën e caktuar;</p> <p>d) ventilet e bombolave të jenë të mbyllura mirë;</p> <p>e) të ndalohet rreptësisht hyrja e të papunësuarve dhe përdorimi i mjeteve që shkaktojnë zjarr.</p> <p>27.3 Duke prezumuar respektimin e kushteve të mësipërme, distancat minimale të sigurisë për bombolat bosh të GLN-së lejohet të jenë si më poshtë:</p> <p>a) nga stiva ose magazina me</p>	<p>a) magazin praznih boca TGN-a treba biti u otvorenom prostoru;</p> <p>b) prazne boce se magaziniraju u posebnim slogovima i poluprečnik zone magaziniranja da se obeleži jasno u zemlji i vidnom mestu tablicom gde se napiše: «SAMO ZA PRAZNE BOCE».</p> <p>c) da se izvrši stroga kontrola da bi se osigurao samo magaziniranje praznih boca u određenoj zoni.</p> <p>d) ventili boca da budu dobro zatvoreni;</p> <p>e) da strogo zabrani ulazak nezaposlenih i korišćenje sredstva koja prouzrokuju vatru.</p> <p>27.3 Pretpostavljajući poštovanje gorenavedenih uslova, minimalna razdaljina sigurnosti za prazne boce TGN-a, dozvoljava se da bude kao dolenavedeno:</p> <p>a) od sloga ili magazina sa punim</p>	<p>a) the storage of LPG containers should be out-doors;</p> <p>b) empty containers should be stored in extra stocks and the perimeter of the storing area should be clearly marked: “EMPTY CONTAINERS ONLY”;</p> <p>c) the strict control to ensure the storage of the empty containers in the determined place;</p> <p>d) to close the facets;</p> <p>e) to strictly forbid the entrance of non-employees and the usage of fire-causing materials.</p> <p>27.3 Presuming that the requirements are fulfilled, the minimal safety distances for empty containers are allowed to be:</p> <p>a) from the pile or storage room</p>
---	---	--

<p>bombola plot të GLN-së – 3 metra;</p> <p>b) nga kufiri i pronës, ndërtesa, burimi shpërthimit – 2 metra;</p> <p>c) nga bombola oksigjeni, enë që përmbajnë lëndë që ndizen lehtë – 2 metra.</p> <p style="text-align: center;">Neni 28 Ruajtja e bombolave jashtë ndërtesave</p> <p>28.1 Bombolat e GLN-së që ende nuk janë përdorur, zëvendësuar ose të shitur mund të ruhen jashtë ndërtesave duke ju përmbajtur rregullave të më poshtme.</p> <p>a) bombolat të vendosen në largësi së paku 1.5 metra nga çfarëdo dere e ndërtesës që frekuentohet nga publiku;</p> <p>b) largësia nga trotuaret dhe kufiri i truallit të mos jetë më e vogël se 3 metra;</p> <p>c) sasia e GLN-së në ruajtje të mos jetë më e madhe se 300 kg. Për sasi ruajtje më të madhe të respektohen</p>	<p>bocama TGN-a – 3 metra;</p> <p>b) od granice poseda, zgrade, izvor eksploziranja – 2 metra;</p> <p>c) od boca oksigena, suda koja sadrže materije koja se lako pale – 2 metra.</p> <p style="text-align: center;">Član 28 Čuvanje boca izvan zgrada</p> <p>28.1 Boce TGN-a koja nisu korišćene, zamenjene ili prodane mogu se čuvati izvan zgrada, poštujući dolenađena pravila:</p> <p>a) boce da se postave u razdaljini najmanje 1.5 metara od bilo kojih vrata zgrade koja se frekventira od strane publike;</p> <p>b) razdaljina od trotoara i granice poseda da ne bude manja od 3 metara;</p> <p>c) količina TGN-a za čuvanje da ne bude veća od 300 kg. Za veću količine za čuvanje, da se ispoštuju</p>	<p>with full containers– 3 meters;</p> <p>b) from the property boundary, the building, the source of explosion – 2 meters;</p> <p>c) from the oxygen container, containing flammable substances – 2 meters.</p> <p style="text-align: center;">Article 28 The safeguard of the containers outside of the buildings</p> <p>28.1 The containers that have not been used, replaced or sold yet, can be kept outside of the buildings regarding these regulations.</p> <p>a) the containers should be placed in a distance of 15 meters from any door frequented by people;</p> <p>b) distance from sidewalks and the ground boundary to be not less than 3 meters;</p> <p>c) the quantity of LPG in storage should not be more than 300 kg. For this kind of storage, the requirements</p>
---	---	---

<p>kërkesat sipas nenit 19;</p> <p>d) kur sasia e GLN-së në ruajtje e kalon 100 kg, bombolat duhet të vendosen në paleta.</p> <p>IV. EKZAMINIMI I PAJISJEVE NËN PRESION</p> <p>Neni 29 Ekzaminimi i enëve që punojnë nën presion</p> <p>29.1 Pajisjet nën presion i nënshtrohen kontrolleve teknike të cekura më poshtë:</p> <p>a) shikimit të jashtëm;</p> <p>b) shikimit të brendshëm;</p> <p>c) provës hidraulike para vënies së tyre në shfrytëzim, periodikisht sipas radhës gjatë shfrytëzimit dhe jashtë afatit të caktuar;</p> <p>d) provës pneumatike të enës së brendshme;</p>	<p>zahtevi prema Članu 19;</p> <p>d) kada količina TGN-a u čuvanju prelazi 100 boce treba postavljati u paletama.</p> <p>IV. ISPITIVANJE OPREME POD PRITISKOM</p> <p>Član 29 Ispitivanje sudova koja rade pod pritiskom</p> <p>29.1 Opreme pod pritiskom podvrgavaju se tehničkim kontrolama, koje su dole navedene:</p> <p>a) vanjskim razgledanje;</p> <p>b) unutrašnjim razgledanjem;</p> <p>c) prije puštanje u pogon , povremeno prema redu tokom korišćenja i izvan određenog roka;</p> <p>d) pneumatskih probi unutrašnjih sudova;</p>	<p>in article 19 should be respected;</p> <p>d) when the quantity of LPG exceeds 100 kg, the containers should be placed in pallets.</p> <p>IV. EXAMINATION OF CONTAINERS UNDER PRESSURE</p> <p>Article 29 Examination of containers working under pressure</p> <p>29.1 Equipments under pressure are submitted to the technical control presented below:</p> <p>a) outside verification;</p> <p>b) inside verification;</p> <p>c) the hydraulic testing before usage, periodically according the line during usage;</p> <p>d) pneumatic testing of the internal container;</p>
---	--	--

<p>e) verifikimi i vakumit të enës së jashtme pas mbushjes të enës së brendshme me gaz të lëngëzuar (për gazra atmosferike të lëngëzuar; oksigjen, azot dhe argon);</p> <p>f) verifikimi i funksionalitetit të enës, pajisjeve në te dhe pajisjeve siguruese;</p> <p>g) prova në hermeticitet;</p> <p>h) matja e trashësisë të mureve të enës me ultratinguj;</p> <p>i) llogaria kontrolluese;</p> <p>j) shqyrtimet radiografike/rëntgen, të lidhjeve të salduara 100 %, të GLN-së dhe gazrave teknike.</p> <p>29.2 Kur nuk ekziston mundësia e shikimit të brendshëm (veçorive konstruktive të enëve), atëherë mund të zëvendësohet me provën hidraulike duke kontrolluar edhe ato pjesë që mund të shikohen.</p>	<p>e) proveravanje banjskog suda nakon punjenja suda tečnim gasom (atmosferskim gasovima, kisikom, dušikom, argonom, idr);</p> <p>f) proveravanje funkcionalnosti suda, opreme u njoj i sigurnosnih oprema;</p> <p>g) proveravanje hermetičnosti;</p> <p>h) merenje debljine zidova suda ultrazvukovima;</p> <p>i) kontrolni obračun;</p> <p>j) radiografsko/rentgensko razmatranje švajsovanih veza 100 %, TGN-a i tehničkih gasova.</p> <p>29.2 Kada ne postoji mogućnost unutrašnjeg razgledanja (konstruktivnih osobina suda) onda se može zameniti hidrauličkim ispitivanjem kontrolišući i one delove koji se mogu razgledati.</p>	<p>e) verification of the vacuum after the filling of the internal container with liquid gas (for liquid atmospheric gases: oxygen, nitrogen and argon);</p> <p>f) verification of the functionality of the container, gadgets in it and safety devices;</p> <p>g) airtight testing;</p> <p>h) the measurement of the thickness of the walls of the container with ultra-sound;</p> <p>i) controlling account;</p> <p>j) roentgen/radiographic verifications of the welding of 100% percentage of LPG and technical gases.</p> <p>29.2 When no possibility for internal verification (constructive features of the container) exists, then it can be replaced with the hydraulic test, checking the parts that can be verified.</p>
--	--	---

<p>29.3 Prova hidraulike e enëve të reja të sapo montuara lejohet të mos bëhet, në qoftë se nga koha e kryerjes së saj në ndërmarrjen prodhuese nuk ka kaluar më tepër se 12 muaj, gjithashtu nuk kanë dëmtime gjatë transportit, vendosjes si dhe nuk është përdorur saldimit në elementët që punojnë nën presion.</p> <p>29.4 Pajisjet që ndodhen në shfrytëzim dhe që janë të regjistruara në IPNP, kontrollohen nga inspektori për të siguruar gjendjen e sipërfaqeve të brendshme e të jashtme si dhe ndikimin e mjedisit në muret e enës, sipas afateve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) shikimi i jashtëm një herë në vit; b) shikimi i brendshëm një herë në tre vjet; c) prova hidraulike me kontroll paraprak të brendshëm një herë në pesë vjet; d) prova hidraulike dhe shikimi i brendshëm për klor çdo dy vjet; e) kontrolli i vakumit të enës së 	<p>29.3 Hidrauličko ispitivanje novih sudova koji su skoro montirane, dozvoljeno je učiniti, ako od vremena proizvodnje u proizvodnom preduzeću nije prošlo više od 12 meseci, takođe ne poseduje oštećenja tokom prevoza, postavljanja kao i nije korišćeno zavarivanje sa drugim elementima koji rade pod pritiskom.</p> <p>29.4 Opreme koje su u korišćenju i koje su registrovane kod IOPP, ispitivanju se od strane inspektora da bi se osigurao o stanju unutra i vanjskih površina kao i o uticaju okoline na zidove suda, prema dolenavedenim rokovima:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) vanjsko razgledanje jednom godišnje; b) unutrašnje razgledanje jednom u tri godine; c) Hidrauličko ispitivanje sa prethodnom kontrolom – jednom u pet godina; d) hidrauličkim ispitivanjima i unutrašnje razgledanje zbog hlora, - svake druge godine; 	<p>29.3 the hydraulic testing of installed new containers is allowed to skip, if by the time it's done, there have been not more than 12 months, and also have not endured any damage during transport and installation and no welding has been done in the under pressure elements.</p> <p>29.4 The containers that are in usage and registered in the IGUP, are controlled by the inspector to ensure the status of the internal and external surfaces, and also the effect of the environment on the side walls, according to the terms below:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) external verification – once a year; b) internal verification – once in three years; c) hydraulic testing with internal control – once in five years; d) hydraulic testing and internal verification on chlorine;
---	--	---

<p>jashtme, çdo tri vjet;</p> <p>f) prova në hermeticitet çdo herë pas intervenimeve në pajisje ose në aksesorët e pajisjes;</p> <p>g) matja e trashësisë kur inspektori vlerëson se për shkak të korrozionit të theksuar ka tëhollim të trashësisë të mureve të pajisjes nën presion;</p> <p>h) llogaria kontrolluese bëhet kur ka zvogëlim të dukshëm të trashësisë së mureve të pajisjes;</p> <p>i) kontrollit teknik para afatit dhe sa herë që IPNP-ja e vlerëson të arsyeshëm;</p> <p>j) intervali i kontrolleve teknike të valvuleve të sigurisë si dhe bazhdarimi i tyre bëhet në intervale sipas udhëzimeve të prodhuesit, kurse së paku një herë në vit, mbi kontrollin dhe bazhdarimin e valvuleve të sigurisë mbahet evidencë e përhershme.</p>	<p>e) kontrola vakuma vanjskog suda, svake treće godine;</p> <p>f) ispitivanje hermetičnosti, svaki put nakon intervencija u opremi pod pritiskom;</p> <p>g) merenje debljine kada inspektor proceni da zbog korozije postoji vidljivo stanjivanje zidova pod pritiskom;</p> <p>h) kontrolni proračun se vrši kada postoji vidljivo smanjivanje debljine zidova opreme;</p> <p>i) tehnička kontrola prije roka svaki put kada IOPP procenjuje da je potrebno;</p> <p>j) interval tehničkih kontrola sigurnosnih ventila i njihovo baždarenje se vrši u intervalima prema uputstvu proizvođača, ali najmanje jednom godišnje, o kontroli i baždarenju ventila sigurnosti se drži stalna evidencija.</p>	<p>e) vacuum control of the external container – every three years;</p> <p>f) airtight testing every time after interventions in the containers or the containers accessories;</p> <p>g) the measurement of the width when the inspector estimates that because of the corrosion, a emaciate of the width of the walls of the container under pressure;</p> <p>h) the controlling account is done when a increase of the wall’s width;</p> <p>i) technical control before the deadline, every time IGUP decides to do so;</p> <p>j) the interval of the technical controls of the safety valves and the calibration of them is done in accordance with the producer’s instructions, while a permanent evidence of the check of the safety valve is done once a year.</p>
---	--	--

<p>29.5 Prova hidraulike bëhet me ujë ose me çdo fluid tjetër që nuk ka veti brejtëse, helmuese dhe që nuk paraqet rrezik shpërthimi.</p> <p>29.6 Uji që përdoret për prova hidraulike duhet të jetë i pastër. Temperatura e ujit nuk guxon të jetë më e lartë se 50 °C as më e ulët se 10 °C. Presioni provues nuk guxon ta kalojë vlerën më të madhe se 1,5 herë të presionit punues.</p> <p>29.7 Në kushte kur prova hidraulike është e pamundur të bëhet për shkak të: tensioneve të mëdha nga pesha e ujit në bazamente, ka mbulim ndërmjet kateve dhe në vetë enën, vështirësi në largimin e ujit, veshje të enës me tulla ose izolim që pengojnë mbushjen e enës me ujë, atëherë lejohet zëvendësimi i saj me provën pneumatike me ajër ose me gaz inert, me të njëjtën vlerë të provës hidraulike. Një provë e tillë lejohet të bëhet kur vërtetohet se janë përfituar rezultate pozitive nga shikimi i brendshëm i kujdesshëm dhe kontrolli i enës në qëndrueshmëri me llogaritje.</p>	<p>29.5 Hidraulično ispitivanje vodom ili bilo kojim fluidom koji ne poseduje svojstva zagrizanja, trovanja i koji ne predstavljaju opasnost eksploziranja.</p> <p>29.6 Voda koja se koristi sa hidraulička ispitivanja treba biti veoma čist. Temperatura vode ne sme biti viša od 50 °C ni niza od 10 °C. Probni pritisak ne sme da prevazilazi iznos od 1,5 puta radnog pritiska.</p> <p>29.7 U uslovima kada hidrauličko ispitivanje je nemoguće da se izvrši zbog: visokih pritisaka od težine vode u bazamentima, postoji pokrivanje između spratova u samom sudu, oblaganje suda ciglama, poteškoća ili izoliranje koje onemogućava odstranjivanje vode, onda se dozvoljava njeno zamenjivanje pneumatskim ispitivanjem vazduhom, inertnim gasom, iste vrednosti hidrauličkog ispitivanja. Jedno takvo ispitivanje je dozvoljeno da se izvrši kada se ustanovi da su dobijeni pozitivni rezultati iz pažljivog unutrašnjeg pregledavanja i kontrole suda u postojanosti i obračunu.</p>	<p>29.5 The hydraulic testing is done with water or with any other fluid that does not have corrosive and poisonous abilities and is non-explosive.</p> <p>29.6 The water used in hydraulic testing should be clean, the temperature of the water should not exceed 50 C and not less than 10 C. the testing pressure should not exceed the value of 1.5 times the working pressure.</p> <p>29.7 if a hydraulic testing is not possible because of the high pressures of the waters in the basements, a covering between floors and the container itself is present, trouble while clearing the water, the coating of the container with bricks or insulation that block the water out of the container, then it's allowed to replace with the pneumatic test with air or inert gas, with the same value as the hydraulic test. Such test is allowed when positive results have come out of the internal verification.</p>
---	--	--

<p>29.8 Gjatë kryerjes së provës pneumatike, merren masa shumë të kujdesshme e të rrepta sigurie dhe veprohet si më poshtë:</p> <p>a) ventili i linjës nga buron presioni dhe manometri vendosen jashtë lokalit ku ndodhet ena që do të provohet;</p> <p>b) me rastin e ngritjes së presionit gjatë provës, njerëzit duhet të largohen nga vendi i provës;</p> <p>c) ena mbahet nën presion gjatë provës pneumatike në periudhë kohore prej 5 minutash;</p> <p>d) pastaj presioni ulet deri në presionin e punës dhe pastaj fillon kontrolli i enës, nëpërmjet shikimit të tegelave të saj dhe lidhjeve të kapshme, duke përdorur tretësirë sapuni ose ndonjë mënyrë tjetër;</p> <p>e) ndalohet goditja e enës gjatë provës pneumatike.</p>	<p>29.8 Tokom vršenja pneumatskog ispitivanja, preduzimaju se veoma stroge i pažljive mere sigurnosti i deluje se kao dolena vedeno:</p> <p>a) ventil linije koji izvire iz pritiska i manometar postavlja se izvan prostorije gde se nalazi sud koji se ispituje;</p> <p>b) prilikom povećanja pritiska tokom ispitivanja, ljudi se odstranjuju od mesta ispitivanja;</p> <p>c) sud se drži pod pritiskom tokom pneumatskog ispitivanja u vremenskom periodu od 5 minuta;</p> <p>d) potom, pritisak se smanjuje do radnog pritiska i tada počinje kontrola suda, preko pregledavanja njenih varova koristeći sapunski rastvor ili neki drugi način;</p> <p>e) zabranjuje se udaranje suda tokom pneumatskog ispitivanja.</p>	<p>29.8 while performing the pneumatic test, very cautious safety measurements are taken and this is how one should act:</p> <p>a) the line valve where the pressure derives and the manometer are placed outside the facility where the container is being tested;</p> <p>b) in case of the increase of the pressure during the test, people should leave the site;</p> <p>c) the container should be kept under pressure during the pneumatic period of 5 minutes;</p> <p>d) the pressure drops to the work pressure and then the container control starts, through verification of it's welding, using soap solution or any other way;</p> <p>e) hitting the container is forbidden during the test.</p>
---	---	---

<p>29.9 Enët për ruajtjen e oksigjenit apo të azotit të lëngëzuar si dhe të lëngjeve të tjera kriogjene jo brejtëse, të cilat janë të mbrojtura me izolim sipërfaqësor apo mbi bazën e vakumit (me mbështjellës dy-shtresor), i nënshtrohen kontrollit teknik jo më rrallë se një herë në dhjet (10) vjet (shikim i brendshëm dhe provë hidraulike).</p>	<p>29.9 Sudovi sa çuvanje oksigjena ili dušika, kao i ostale kriogene i nekorozivne tečnosti, koja su zaštićena površinskim izolacijom ili na osnovu vakuma (sa dvoslojnim omotačem) podvrgava se tehničkoj kontroli, ne rede od jednom u deset (10) godina (unutrašnje pregledavanje i hidrauličko ispitivanje).</p>	<p>29.9 The oxygen storing containers and other cryogenic and non-corrosive liquids which are protected with surface insulation or on the vacuum base (with double coating), is submitted to technical control in not less than once in ten (10) years.</p>
<p>29.10 Kontrolli teknik i enëve që ndodhen të mbuluara nën tokë, kur nuk kanë mjedis brejtës ose gaz nafte me përmbajtje të gazit sulfhidrik jo më shumë se 5 g për 100 m³, bëhet pa i nxjerrë ato nga toka dhe pa ia hequr izolimin e jashtëm, me kusht që të matet trashësia e mureve me njërën nga metodat pa shkatërrim. Këtyre enëve iu bëhet shikimi i brendshëm dhe prova hidraulike një herë në 10 vjet.</p>	<p>29.10 Tehnička kontrola sudova koji se nalaze pokrivena pod zemljom, kada ne poseduju grižljivu okolinu ili naftni gas sa sadržajem sulfhidratnog gasa više od 5 g za 100 m³, vrši se ne vadeći iste iz zemlje i ne skidajući vanjsku izolaciju, pod uslovom da se izmeri debljina zidova sa jednim od metoda bes uništenja. Ovim sudovima se vrši unutrašnji pregled i hidraulično ispitivanje jednom u 10 godina.</p>	<p>29.10 The technical control of the containers stored underground, where no corrosive or petroleum gas is present, is done without taking them out of the ground, in order to maintain the width of the walls. These containers are submitted to internal verification and pneumatic testing once in 10 years.</p>
<p>29.11 Prova hidraulike e kaldajave utilizatore, për përfitimin e sulfetit (në fabrikat e letrës dhe të celulozës) si dhe aparateve të hidrolizës, me veshje zjarrdruese antiacide, lejohet të mos bëhet me kusht që kontrolli i mureve metalike të këtyre kaldajave dhe aparateve të bëhet me anë të defektoskopisë me ultrazë. Kontrolli</p>	<p>29.11 Hidraulično ispitivanje utilizatorskih kotlova, za dobivanje sulfida (u fabrika papira i celuloze) kao i aparatima za hidrolizu, sa antiacidnim vatrostalnom izolacijom, dozvoljava se da se ne vrše pod uslovom da kontrola metalnih zidova ovih kotlova i aparata da se pomoću defektoskopije ultrazvukom.</p>	<p>29.11 The hydraulic testing of the utilizing furnaces, for sulfate profit (in paper and cellulose industry) and the hydrolysis gear, with anti-acid fire proof coating, is allowed to skip in order that the control of the furnaces and the gear is done using defecto-scope with ultra-sound. The ultra-sound testing is done by a specialized</p>

<p>me ultrazë bëhet nga një ndërmarrje e specializuar për këto lloje punimesh. Ky kontroll bëhet në periudhën e riparimeve të përgjithshme të agregateve të më sipërme, por jo më rrallë se një herë në katër vjet. Kontrolli bëhet në një vëllim jo më pak se 50 % të gjatësisë së tegelave të salduara, në mënyrë që kontrolli me ultratinguj në masën 100% të plotësohet jo më rrallë se një herë në 8 vjet.</p>	<p>Kontrola ultrazvukom se vrši u specijalizovanim institucijama za ovu vrstu radove. Ova kontrola se vrši u periodu opštih remontovanja gornjih agregata, ali ne rede od jednom u četiri godine. Kontrola se vrši u jednoj zapremeni ne manjom od 50 % dužine zavarenih varova, na takav način da kontrola ultrazvukovima u masi 100% da se izvrši ne redje od jednom u 8 godina.</p>	<p>enterprise. This sort of control is done once in 4 years and it is done in the time of the reparations of the upper aggregates. The control is done in a 50% volume of the lengths of the welding so the 100% test is done once in 8 years.</p>
<p>29.12 Enët që punojnë me mjedise brejtëse dhe janë të regjistruara në IPNP, shikimi i brendshëm u bëhet një herë në dy vjet, ndërsa prova hidraulike një herë në katër vjet.</p>	<p>29.12 Sudovi pod pritiskom koji rade u korozivnim ambijentima i registrovani su u IOPP-um unutrašnji pregled se vrši jednom u dve godine, dok hidraulično ispitivanje jednom u četiri godine.</p>	<p>29.12 The containers working with corrosive environments and are registered in the IGUP, the internal verification is done twice a year, while the hydraulic test once in 4 years.</p>
<p>29.13 Enët iu nënshtrohen kontrolleve teknike para afatit të caktuar, në rastet e më poshtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) gjatë rikonstrukcioneve dhe riparimeve kur është përdorur saldimi ose ngjitja e pjesëve të veçanta të enës; b) nëse një enë e re nuk është vënë në punë më shumë se një vit; c) kur ena është çmontuar dhe është 	<p>29.13 Sudovi se podvrgavaju tehničkim kontrolama prije određenog roka, u slučajevima koji se dole navedeni:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) tokom rekonstrukcija i remonta, kada je korišćeno zavarivanje ili lepljene posebnih delova suda; b) ako jedan novi sud nije stavljen u pogon više od jedne godine; c) kada je sud demontiran i postavljen 	<p>29.13 The containers are submitted to technical controls before the deadline only in these cases:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) during re-constructions and repairing when the welding is done or the soldering of particular parts of the container; b) if a new container is not put to work in more than a year; c) when the container is dismantled

<p>vendosur në një vend tjetër;</p> <p>d) kur para vënies në shfrytëzim të enës, mbulimi me shtresë mbrojtëse të saj bëhet nga ndërmarrja që e ka në shfrytëzim;</p> <p>e) kur inspektori ose personi, i cili përgjigjet për punë të sigurt dhe pa rreziqe të enës apo kur përfaqësuesi i caktuar nga ndërmarrja e shikon të arsyeshëm një kontroll të tillë.</p> <p>29.14 Ndërmarrjet apo institucionet, të cilat kanë në shfrytëzim pajisjet që punojnë nën presion, i kryejnë kontrolle teknike si më poshtë:</p> <p>a) shikimin e brendshëm dhe provën hidraulike të gjitha enëve, para vënies së tyre në shfrytëzim e që nuk regjistrohen në IPNP, por që regjistrohen nga vetë ato;</p> <p>b) shikimin e brendshëm të të gjitha enëve (që regjistrohen dhe që nuk regjistrohen në Inspektorat), jo më rrallë se një herë në dy vjet. Përfshihen enët që punojnë me mjedise brejtëse, shikimi i brendshëm i tyre bëhet jo më rrallë se një herë në</p>	<p>na jedno drugo mesto;</p> <p>d) kada, prije stavljanja suda u pogon, pokrivanje zaštitnim slojem se vrši od strane preduzeća koje ga koristi;</p> <p>e) kada inspektor ili lice, koji odgovara za siguran rad i bez opasnosti suda, ili kada određeni predstavnik od preduzeća smatra potrebnim jednu takvu kontrolu.</p> <p>29.14 preduzeća ili institucije, koja poseduju na korišćenje opremi pod pritiskom, vrše tehničke kontrole kao dolenađeno:</p> <p>a) unutrašnje pregledavanje i hidraulično ispitivanje svih sudova, prije puštanja u pogon i koja se ne registruju kod IOPP, nego se registruju od njih samih;</p> <p>b) unutrašnji pregled svih sudova (koja se registruju kod Inspektorata) ne ređe od jednom u dve godine. Izuzimaju se sudovi koji rade u nagrizajucim ambijentima, unutrašnji pregled tih sudova, se vrši ne ređe od jednom godišnje. Ova dispozicija se</p>	<p>and is placed in another location;</p> <p>d) when before the usage of the container, the protecting coating is performed by the operating enterprise;</p> <p>e) when the inspector or the person who is responsible for non-risk work of the container or when the official appointee of the enterprise sees it as reasonable to do such control.</p> <p>29.14 Enterprises or institutions, which are operating the containers, perform technical controls as listed below:</p> <p>a) the internal verification and hydraulic testing of all containers before presenting them to usage and that are not registered in the IGUP, but that are registered by themselves;</p> <p>b) internal verification of all containers (registered or not in the inspectorate) not less than once in two years. Excepted are the containers working in corrosive environments, which's verification is done once a year. This provision is not applied for</p>
---	---	--

